

Statistika të Diplomimeve


2016-2017

Tiranë, më 3 Gusht 2018: Në vitin 2017, në arsimin 9 vjeçar u diplomuan 36.546 nxënës, ose 96,4 % e nxënësve të klasës së nëntë të vitit shkollor 2016-2017, duke shënuar një rritje prej 1,4 pikë përqindje krahasuar me vitin paraardhës. Në këtë nivel arsimor, u diplomuan 52,7 % djem dhe 47,3 % vajza.

Në vitin 2017 në arsimin e mesëm, u diplomuan 36.436 nxënës, duke shënuar një rënie prej 5,6 % krahasuar me 2016. Raporti bruto i diplomimit (numri i të diplomuarve pavarësisht moshës në një nivel ose program të caktuar, të shprehur si përqindje e popullsisë në moshën e diplomimit teorik, për atë nivel apo program) për arsimin e mesëm është 80,1 %.

Në arsimin e mesëm, u diplomuan 49,4 % djem dhe 50,6 % vajza.


Fig. 1 Shkalla e diplomimit në arsimin e mesëm



Të Diplomuar në arsimin e lartë

Në vitin 2017, janë diplomuar në arsimin e lartë 35.173 studentë, ose 11,0 % më shumë se në vitin 2016. Ndër të diplomuarit e këtij viti 64,1 % janë gra dhe 35,9 % janë burra. Të diplomuarit në programet Bachelor përbëjnë 58,1 % të studentëve të diplomuar gjithsej.

Fig. 2 Të Diplomuar në arsimin e lartë sipas fushës së studimit, 2017




Fusha “biznes administrim dhe ligj”, shënon numrin më të lartë të të diplomuarëve, me 29,6 %, ndjekur nga fusha “shëndet dhe mirëqenie” me 13,6 %, dhe “shkencë sociale, gazetari dhe informacion” me 12,2 %.

Në vitin 2017, të diplomuarit sipas fushave të studimit, mbajnë përqindje të ndryshme për burrat dhe gratë ndër të diplomuarit gjithsej.

Fushat ku janë diplomuar më shumë gratë janë “arsim” me 80,5 %, ndjekur nga “shëndet dhe mirëqenie” me 76,9 % dhe “shkencë sociale, gazetari dhe informacion” me 75,0 %.

Fushat në të cilat janë diplomuar më shumë burrat janë “shërbime” me 72,0 %, “inxhinieri, prodhim dhe ndërtim” me 60,2 %, dhe “bujqësi, pyje, peshkim dhe veterinar” me 57,7 %.

Fig. 3 Të Diplomuar në arsimin e lartë sipas fushës së studimit dhe gjinisë, 2017



Sipas Manualit të fushave të studimit ISCED F-2013.

Burimi i të dhënave të diplomimeve : MASR

Shpjegime metodologjike

Arsimi në Shqipëri është i organizuar sipas këtyre programeve dhe klasifikuar sipas Klasifikimit ISCED-2011 që përdoret ndërkombëtarisht në statistikat e arsimit :

Niveli 0 - Arsimi parashkollor – çerdhe / kopshte

Niveli 1 - Arsimi fillor ose cikli i ulët i arsimit bazë

Niveli 2 - Arsimi i mesëm i ulët ose cikli i lartë i arsimit bazë

Niveli 3 - Arsimi i mesëm i lartë - Gjimnaz / Profesional / Social kulturor

Niveli 4 - Arsimi pas të mesmes por jo i lartë

Niveli 5 - Arsimi i lartë cikël i shkurtër

Niveli 6 - Bachelor ose ekuivalent

Niveli 7 - Master ose ekuivalent

Niveli 8 - Doktoraturë ose ekuivalent

PËRKUFIZIME

Arsimi parauniversitar përfshin arsimin që kryhet nga institucionet arsimore si kopshte, shkolla 9 vjeçare dhe të mesme.

Arsimi 9 vjeçar ose arsimit bazë, përbëhet nga dy cikle: cikli i ulët ose arsimit fillor, i cili kryhet në klasat 1 - 5 dhe cikli i lartë ose arsimit i mesëm i ulët, i cili kryhet në klasat 6 - 9. Arsimit 9 vjeçar është i detyruar, fillon në moshën 6 vjeç dhe zgjat 9 vjet. Nxënësi ka detyrimin të ndjekë arsimin bazë deri në moshën 16 vjeç.

Arsimi i mesëm përfshin gjimnazin, arsimin profesional, cili ndahet në të ulët teknik dhe të lartë, si edhe atë social – kulturor. Ky i fundit paraqitet në statistika bashkë me arsimin profesional.

Arsimi profesional përfshin programet e arsimit të dizajnuara me qëllimë përfitimin e njohurive, shkathtësitë dhe kompetencat specifike për një profesion të veçantë, klasë të profesioneve, ose tregti.

I diplomuar në një program arsimor, është një nxënës ose student, i cili ka përfunduar në mënyrë të sukseshme të gjitha kërkesat e programit.

Raporti bruto i diplomimit është numri i të diplomuarve pavarësisht moshës në një nivel ose program të caktuar, të shprehur si përqindje e popullsisë në moshën e diplomimit teorik, për atë nivel apo program.